


ÇFARË NDODH PAS DIPLOMIMIT NGA SHKOLLA

Rezultatet nga
gjurmimi i të
diplomuarve
2016-2022



Ky raport është hartuar nga Jonida Jani nën kujdesin e Aleka Papa, Projekti “Aftësi për Punë” (S4J).
Koordinatorë për gjurmimin në Shkollën Tregtare: Zinete Bejtaj

Rreth projektit “Aftësi për Punë” S4J

“Aftësi për Punë” S4J është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), i cili zbatohet në Shqipëri nga organizata Swisscontact. S4J adreson sfidat kryesore në Arsimin dhe Formimin Profesional (AFP) në Shqipëri duke investuar për sigurimin e ndryshimeve sistematike, zhvillimin e kompetencave dhe fuqizimin e aktorëve. S4J mbështet ofruesit partnerë të AFP-së në drejtim të krijimit të lidhjeve të ngushta me kompanitë e sektorit privat dhe partnerë të tjerë, diversifikimit dhe përmirësimit të ofertës mësimore, aplikimit të metodave të reja të mësimdhënies dhe standardeve të cilësisë, realizimit të praktikave mësimore në mjediset e biznesit dhe zhvillimit e fuqizimit të institucionit.

Lista e figurave

Figura 1: Shpërndarja sipas gjinisë (2022)	7
Figura 2: Shpërndarja sipas drejtimeve (2022)	7
Figura 3: Vendbanimi i të diplomuarve (2020-2022)	8
Figura 4: Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit (2022)	8
Figura 5: Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit (2016-2022)	9
Figura 6: Punësimi përkundrejt vetë-punësimit (2016-2022)	10
Figura 7: Statusi i punësimit një vit pas diplomimit sipas drejtimeve (2022)	10
Figura 8: Statusi i punësimit një vit pas diplomimit sipas gjinisë (2022)	11
Figura 9: Lidhja e punës me fushën e arsimit (2016-2022)	11
Figura 10: Lidhja e punës me fushën e arsimit sipas drejtimit (2016-2022)	11
Figura 11: Lidhja e punës me arsimin sipas gjinisë (2022)	12
Figura 12: Niveli i pagave një vit pas diplomimit (net) 2022	14
Figura 13: Niveli i pagave një vit pas diplomimit (net)	15
Figura 14: Niveli i pagave sipas drejtimit (2022)	15
Figura 15: Niveli i pagave sipas gjinisë (2022)	16
Figura 16: Punësimi me kohë të plotë përkundrejt me kohë të pjesshme (2016-2022)	16
Figura 17: Madhësia e kompanisë (2016-2022)	17
Figura 18: Lloji i kontratës (2016-2022)	18
Figura 19: Ndërgjegjësimi rreth pagesës së sigurimeve nga punëdhënësi (2016-2022)	18
Figura 20: Periudha kohore në kërkim të një pune (të diplomuarit 2022)	19
Figura 21: Ndjekja e kualifikimeve të mëtejshme (2016-2022)	21
Figura 22: Llojet e kualifikimeve të mëtejshme (2016-2022)	22
Figura 23: Lloji i institucionit (2020-2022)	22
Figura 24: Lidhja e studimeve me profesionin (2020-2022)	23
Figura 25: Papunësia ndër vite	24
Figura 26: Niveli i të diplomuarve pa punë që kërkojnë për punë (2020-2021)	24
Figura 27: Metodatat e kërkimit për punë (2020-2022)	25
Figura 28: Niveli i të diplomuarve papunë që kanë qenë në marrëdhënie pune (2016-2022)	26
Figura 29 Përzgjedhja e së njëjtës shkollë dhe degë (2018-2022)	27
Figura 30: Përzgjedhja e së njëjtës degë studimi (2018-2022)	28
Figura 31: Përzgjedhja e së njëjtës shkollë (2018-2022)	29

Lista e tabelave

Tabela 1: Mbulimi i gjurmimit	6
Tabela 2: Arsyet e mospërputhjes së punës me fushën e arsimit (2018-2022)	12
Tabela 3: Niveli i përdorimit të njohurive të fituara gjatë studimeve (2016-2022)	13
Tabela 4: Shkalla e lidhjes së pozicionit aktual të punës me studimet (2016-2022)	13
Tabela 5: Përceptimi për sigurinë dhe kënaqësinë në punën aktuale (2016-2022)	19
Tabela 6: Periudha kohore në kërkim të një pune (2016-2022)	20
Tabela 7: Mënyrat e gjetjes së punës së pare (2016-2022)	20
Tabela 8: Ndhima e shkollës në gjetjen e punës së pare (2016-2022)	21
Tabela 9: Arsyet kryesore për ndjekjen e kualifikimeve të mëtejshme (2016-2022)	23
Tabela 10: Arsyet kryesore pas papunësisë (2016-2022)	25
Tabela 11: Arsyet kryesore e mos kërkimit për punë (2020-2022)	26
Tabela 12: Përqindja e aspekteve ku ka nevojë për përmirësim në shkallë “shumë/jashtëzakonisht shumë” (2016-2022)	27
Tabela 13: Përzgjedhja e së njëjtës degë dhe shkollë sipas drejtimit (2018-2022)	28
Tabela 14: Planet e të diplomuarve për dy vitet e ardhshme (2016-2022)	29

Tabela e përmbajtjes


1. Hyrje – Çfarë është gjurmimi i të diplomuarve?	5
2. Të diplomuarit 2016-2022	6
3. Analiza e rezultateve.....	8
3.1 Statusi i punësimit.....	8
3.2 Lidhja e punës me fushën e arsimit	11
3.3 Përdorimi i njohurive dhe kompetencave të fituara në shkollë në vendin e punës	13
3.4 Niveli i pagave.....	14
3.5 Kushtet e punës	16
3.6 Perceptimet mbi stabilitetin dhe kënaqshmërinë me vendin e punës.....	18
3.7 Kohëzgjatja e gjetjes së punës së parë.....	19
3.8 Mënyrat e gjetjes së punës së parë	20
3.9 Të diplomuarit që ndjekin kualifikime të mëtejshme	21
3.10 Të diplomuarit pa punë.....	23
3.11 Propozimet për përmirësim në shkollë	26
3.12 Planet për të ardhmen	29
4. Përfundime	30

1. Hyrje – Çfarë është gjurmimi i të diplomuarve?

Monitorimi i treguesve kryesorë të tregut të punës për të diplomuarit e një institucioni arsimor realizohet përmes ‘studimeve gjurmuese’ që ndjekin ose ‘gjurmojnë’ të diplomuarit pasi ata diplomohen. Studimet e gjurmimit ofrojnë një tablo më të qartë të performancës së të diplomuarve të arsimit profesional në tregun e punës, duke matur punësimin produktiv të të diplomuarve pas përfundimit të studimeve.

Të dhënat dhe rezultatet e gjurmimit përdoren për të rritur kuptueshmërinë mbi **relevancën e ofertës** për kualifikime duke kontribuar kështu në zhvillimin e aftësive të kërkuara nga tregu i punës dhe në pajisjen e nxënësve me njohuritë dhe aftësitë e duhura. Tematikat e gjurmimit janë të shumëfishta, por kryesisht përfshijnë pyetje që lidhen me tranzicionin nga institucioni arsimor në tregun e punës, kushtet e punës, përputhjen midis arsimit dhe punës aktuale, si dhe vlerësimin në retrospektivë të institucionit arsimor nisur nga përvoja e të diplomuarve.

Avantazhet e një sistemi gjurmimi në nivel ofruesi



Në këtë kuadër, **Shkolla Tregtare**, me mbështetjen e projektit ‘Aftësi për Punë’ (S4J) ka ngritur një **sistem gjurmimi** në nivel ofruesi për të diplomuarit e saj. Ky sistem gjurmimi përmbush dy qëllime të rëndësishme:

- Monitorimin e treguesve kryesorë të tregut të punës për të diplomuarit e shkollës.
- Vlerësimin e lidhjes (përputhshmërisë horizontale) midis arsimit dhe punës.

Zbatimi i procesit të gjurmimit në praktikë zhvillohet në **tre faza kryesore** siç është e ilustruar në diagramën më poshtë.



Në fazën e para-gjurmimit, që kryhet në majin e çdo viti shkollor, realizohet para-gjurmimi i maturantëve që pritet të diplomohen në qershor. Para-gjurmimi kryhet me anë të një pyetësi të strukturuar online. Anketa mbledh të dhënat e kontaktit të maturantëve, karakteristikat e tyre socio-demografike, si dhe planet dhe pritshmëritë e tyre të karrierës për të mundësuar kështu gjurmimin e tyre një vit më pas.

Në fazën e gjurmimit, që kryhet në qershorin e çdo viti shkollor realizohet gjurmimi i të diplomuarve nga shkolla një vit më parë. Të diplomuarit raportojnë mbi përvojën e kalimit në tregun e punës dhe bëjnë vlerësimin në retrospektivë të shkollës së tyre përmes një pyetësi të standardizuar online duke përdorur platformën Kobo Toolbox.

Në fazën përmblyëse të procesit analizohen rezultatet e gjurmimit dhe prezantohen rezultatet. Pjesa më e rëndësishme e procesit është leximi i këtyre gjetjeve dhe reflektimi i brendshëm i institucionit mbi të dhënat dhe ndërmarrja e hapave konkrete si rrjedhojë.

Procesi i gjurmimit koordinohet nga **koordinatori i gjurmimit** me mbështetjen e Njesisë së Zhvillimit dhe mësuesve kujdestarë, nën kujdesin e projektit 'Aftësi për punë'.

Ky raport përmbledhës pasqyron rezultatet kryesore nga gjurmimi i **shtatë brezave me të diplomuar** të Shkollës Tregtare.

2. Të diplomuarit 2016-2022


Në vitin shkollor 2021-2022, në Shkollën Tregtare u diplomuan 61 nxënës (shiko tabelën 1), 1 nxënës më pak sesa gjatë vitit 2020-2021.

Tabela 1: Mbulimi i gjurmimit

Brezi	Të diplomuar	Të anketuar	%
2015-2016	21	8	38%
2016-2017	19	19	100%
2017-2018	48	45	94%
2018-2019	46	43	93%
2019-2020	63	63	100%
2020-2021	63	62	98%
2021-2022	61	61	100%

Nga të diplomuarit e vitit 2021-2022 u gjurmuan 61 nxënës ose 100% e të diplomuarve. Pjesa më e madhe e të diplomuarve të gjurmuar i përkasin gjinisë mashkullore 77% (N=47) dhe vetëm 23% (N=14) gjinisë femërore (shiko figurën 1).


Figura 1: Shpërndarja sipas gjinisë (2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N=61

Ndërsa të shpërndarë sipas drejtimeve (shiko figurën 2), përqindjen më të lartë të të gjurmuarve e kanë të diplomuarit e drejtimit Hoteleri-Turizëm me 85% dhe më të voglin ata të drejtimit Ekonomi-Biznes me 15%.


Figura 2: Shpërndarja sipas drejtimeve (2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N=61

Të pyetur lidhur me vendbanimin, 67% (N=41) e të diplomuarve janë përgjigjur se jetojnë në Shqipëri dhe 33% (N=20) jetojnë jashtë vendit. Sikurse vërehet nga figura 3, raporti mes numrit të të diplomuarve që jetojnë jashtë vendit dhe atyre që jetojnë në Shqipëri ka mbetur i pandryshuar.

Figura 3: Vendbanimi i të diplomuarve (2020-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2020 (N=63); 2021 (N=62); 2022 (N=61)


Nga të diplomuarit që jetojnë jashtë vendit, 8 (tetë) jetojnë në Itali, 5 (pesë) në Gjermani, 2 (dy) në Angli dhe 2 (dy) të tjerë në Francë. Ndërkohë, në Spanjë dhe në Greqi jeton përkatësisht nga 1 (një) i diplomuar në secilin shtet.

3. Analiza e rezultateve

3.1 Statusi i punësimit

Sipas rezultateve të brezit të fundit të të gjurmuarve (2021-2022), nga një total prej 61 të anketuarish 56% ishin të punësuar një vit pas diplomimit (shiko figurë 4), 21% ishin të vetëpunësuar, 8% ishin të punësuar por edhe studionin në të njëjtën kohë, 7%, ishin student/kursant. Ndërkohë, të papunë ishin 7% e të anketuarve.


Figura 4: Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit (2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N=61

85% e të diplomuarve në vitin 2022 janë të punësuar/vetëpunësuar. Referuar figurës 5, dy vitet e fundit (2021 dhe 2022), shënojnë vlerat më të larta të punësimit të të shtatë brezave të gjurmuar. Ndërkohë, përqindja e atyre që janë të papunë ka ardhur në rënie nga viti në vit, për të arritur në vlerën më të ulët në vitin 2022 me vetëm 7%. Përqindja e atyre që vijojnë studimet e mëtejshme këtë vit është 7% (nga 0% në 2021), me një ulje me 4 pikë përqindje referuar vitit 2020 (11%).


Figura 5: Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit (2016-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=8); 2017 (N=19); 2018: (N=45); 2019: (N=43); 2020: (N=63); 2021: (N=62); 2022: (N=61)

Të anketuarit që janë shprehur se janë në marrëdhënie pune janë pyetur më tej nëse janë të punësuar apo të vetëpunësuar. Sikurse vihet re nga figura 6, shumica e të diplomuarve ndër vite janë shprehur se janë të punësuar dhe një numër i vogël prej tyre janë të vetë-punësuar. Megjithatë, gjatë vitit të fundit vërehet një rritje me 13 pikë përqindje e numrit të të diplomuarve të vetëpunësuar. E shprehur në përqindje 56% e të diplomuarve në vitin 2022 janë të punësuar (69% në 2021) dhe 21% janë të vetëpunësuar (8% në 2021). Pra, për kohortin e vitit 2022 vërehet një rritje e vetëpunësimit.


Figura 6: Punësimi përkundrejt vetë-punësimit (2016-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shumica e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=8); 2017 (N=19); 2018: (N=45); 2019: (N=43); 2020: (N=63); 2021: (N=62); 2022: (N=61)

Në figurën 6, jepet statusi i punësimit sipas dy drejtimeve të ofruara nga shkolla. Sikurse vihet re, 88% (N=46) e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm janë të punësuar. Vërehet që ky drejtim është edhe drejtimi i cili ka numrin më të lartë të të papunëve me 8% (N=4). Ndërkohë, drejtimi Ekonomi-Biznes ka të punësuar 67% (N=6) të të diplomuarve, dhe nuk ka të papunë. Në numra absolut 2 të diplomuar në secilin drejtim ndjekin studime të mëtejshme.


Figura 7: Statusi i punësimit një vit pas diplomimit sipas drejtimeve (2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shumica e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** EB (N=9); HT (N=52)

Të ndara sipas gjinisë (shih figurën 8), të dhënat tregojnë se 85% (N=40) e të diplomuarve meshkuj janë të punësuar, 9% (N=4) janë të papunë dhe 6% (N=3) janë student ose kursant. Ndërkohë, 86% (N=12) e të diplomuarve të gjinisë femërore janë të punësuar, 7% (N=1) janë studente ose kursante. Asnjë nga të diplomuarat vajza nuk është e papunë.

Figura 8: Statusi i punësimit një vit pas diplomimit sipas gjinisë (2022)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shumta e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** M (N=47); F (N=14).

3.2 Lidhja e punës me fushën e arsimit

Të pyetur nëse puna aktuale lidhet me fushën e tyre të arsimit, 88% e të diplomuarve u përgjigjën pozitivisht. Ndër vite (shiko figurën 9), rreth 86% e të diplomuarve pohojnë se puna lidhet me fushën e tyre të studimit.


Figura 9: Lidhja e punës me fushën e arsimit (2016-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shumta e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=6); 2017 (N=9); 2018 (N=26); 2019 (N=27); 2020 (N=41); 2021 (N=55); 2022 (N=52)

Nëse analizojmë lidhjen e punës me fushën e arsimit sipas drejtimit (shiko figurën 10), vërehet se mesatarisht (2016-2022) 61% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes dhe 95% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm pohojnë lidhje të punësimit me profesionin. Megjithatë, në raport me vitin 2021, vërehet një rritje me 56 pikë përqindje e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes që pohojnë një lidhje të punësimit me profesionin dhe një rënie me 11 pikë përqindje për të diplomuarit në Hoteleri-Turizëm.


Figura 10: Lidhja e punës me fushën e arsimit sipas drejtimit (2016-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza 2016:** N_{EB}=2, N_{HT}=4; **Baza 2017:** N_{EB}=4, N_{HT}=5; **Baza 2018:** N_{EB}=4, N_{HT}=22; **Baza 2019:** N_{EB}=8, N_{HT}=19; **Baza 2020:** N_{EB}=16, N_{HT}=25; **Baza 2021:** N_{EB}=15, N_{HT}=40; **Baza 2022:** N_{EB}=6, N_{HT}=46

Të ndara sipas gjinisë, të dhënat tregojnë se 88% (N=35) e të diplomuarve të gjinisë mashkullore dhe 92% (N=11) e gjinisë femërore punojnë në profesion.

Figura 11: Lidhja e punës me arsimin sipas gjinisë (2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: M** (N=47); **F** (N=14).

Të pyetur lidhur me arsyet e mospërputhjes së punës me fushën e arsimit (shiko tabelën 2), vërehet se të diplomuarit e brezit 2021-2022 japin vetëm një arsye: puna aktuale ofron pagë/kushte më të mira. Ndër vite arsyeja kryesore ka qenë pamundësia për të gjetur një vend pune që lidhet me studimet (mesatarisht 63%). Një arsye tjetër ka qenë edhe mungesa e ofertës rajonale të punës të lidhur me studimet (mesatarisht 13%).

Tabela 2: Arsyet e mospërputhjes së punës me fushën e arsimit (2018-2022)

	Të diplomuar në 2018	Të diplomuar në 2019	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
Nuk gjeta një vend pune që lidhet me studimet e mia	25%	100%	83%	45%	0%
Nuk dua të punoj në një punë që lidhet me studimet e mia	0%	0%	0%	18%	0%
Nuk ka oferta pune në fushën time në rajon	0%	0%	17%	36%	0%

Puna që kam më ofron pagë/kushte më të mira	75%	0%	0%	0%	100%
---	-----	----	----	----	------

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2018 (N=4); 2019 (N=4); 2020 (N=6); 2021 (N=11); 2022 (N=2)

3.3 Përdorimi i njohurive dhe kompetencave të fituara në shkollë në vendin e punës

Të pyetur nëse njohuritë dhe kompetencat e fituara gjatë studimit i përdorin në vendin e punës (shiko tabelën 3), rezultatet e gjurmimit të të diplomuarve në vitin 2022 tregojnë se njohuritë përdoren “shumë/jashtëzakonisht shumë” nga 46% e të gjurmuarve. Vihet re një rritje me 22 pikë përqindje në krahasim me vitin e mëparshëm (26%). Niveli më i lartë ka qenë ai i vitit 2019 ku 59% e të diplomuarve kanë pohuar se i përdorin njohuritë dhe kompetencat e fituara në shkollë në vendin e punës “shumë/jashtëzakonisht shumë”. Nivel të lartë kanë pohuar edhe të diplomuarit e vitit 2020 me 57%.

Ndërkohë, 6% e të diplomuarve janë përgjigjur se i përdorin “aspak” njohuritë e fituara gjatë studimeve (3% mesatarja e viteve 2016-2021). Ndërsa kategoria e atyre që janë përgjigjur se i përdorin “disi” njohuritë ka pësuar një rënie me 5 pikë përqindje për vitin 2022 (35%), në raport me mesataren e viteve 2016-2021 e cila ka qenë 45%

Tabela 3: Niveli i përdorimit të njohurive të fituara gjatë studimeve (2016-2022)

	Aspak	2	3	4	Jashtëzakonisht shumë
Të diplomuar në 2016	0%	0%	50%	0%	50%
Të diplomuar në 2017	0%	15%	46%	38%	0%
Të diplomuar në 2018	8%	27%	42%	15%	8%
Të diplomuar në 2019	0%	9%	31%	22%	38%
Të diplomuar në 2020	5%	15%	24%	37%	20%
Të diplomuar në 2021	5%	25%	44%	24%	2%
Të diplomuar në 2022	6%	13%	35%	8%	38%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=6); 2017 (N=13); 2018 (N=26); 2019 (N=32); 2020 (N=41); 2021 (N=55); 2022 (N=52)

Të pyetur për lidhjen mes pozicionit të punës dhe studimeve të kryera (shiko tabelën 4), 42% e të diplomuarve në 2022 e vlerësojnë lidhjen e pozicionit të punës me studimet e kryera me “shumë/jashtëzakonisht shumë”. Këtu, vihet re një rritje me 24 pikë përqindje krahasuar me vitin 2021, ku vetëm 18% e të diplomuarve të gjurmuar e vlerësonin lidhjen mes pozicionit të punës me “shumë/jashtëzakonisht shumë”. Nga ana tjetër, 21% e vlerësojnë me “pak/aspak” lidhjen mes pozicionit të punës dhe studimit. Edhe në këtë kategori kemi një përmirësim në raport me vitin e mëparshëm me 9 pikë përqindje (21% në 2022, 30% 2021)

Tabela 4: Shkalla e lidhjes së pozicionit aktual të punës me studimet (2016-2022)

	Aspak	2	3	4	Jashtëzakonisht shumë
Të diplomuar në 2016	0%	17%	17%	33%	33%
Të diplomuar në 2017	0%	15%	46%	38%	0%
Të diplomuar në 2018	8%	23%	42%	15%	12%
Të diplomuar në 2019	3%	19%	22%	25%	31%
Të diplomuar në 2020	5%	17%	24%	27%	27%


Të diplomuar në 2021	5%	25%	51%	18%	0%
Të diplomuar në 2022	4%	17%	37%	15%	27%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=6); 2017 (N=13); 2018 (N=26) 2019 (N=32); 2020 (N=41), 2021 (N=55); 2022 (N=55)

3.4 Niveli i pagave

Përsa i përket nivelit të pagave për të diplomuarit e punësuar, një vit pas diplomimit, për vitin 2022 (shiko figurën 12), shpërndarja e të diplomuarve sipas nivelit të pagave është: 2% më pak se paga minimale, 12% paga minimale-35,000 lekë, 19% në fashën 35,001-50,000 lekë, 10% në fashën 50,001-65,000 lekë, 6% në fashën 65,001-80,000 lekë dhe 52% paguhen më shumë se 80,001 lekë. Pra, më shumë sesa gjysma e të diplomuarve të vitit 2022 paguhen me një pagë më shumë sesa 80,001 lekë.


Figura 12: Niveli i pagave një vit pas diplomimit (net) 2022



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N=52

Një vlerësim krahasues me vitet e kaluara (shiko figurën 13), pasqyron një përmirësim të nivelit të pagave të të diplomuarve. Përqindja e të gjurmuarve që kanë pagë më të ulët se 35.000 lekë është ulur me 53 pikë përqindje nga brezi i parë i gjurmuar 2015-2016 (67% në 2016, 14% në 2022). Ndërkohë, është ulur me 1 pikë përqindje niveli i të diplomuarve që kanë një pagë 50,001-80,001 lekë (17% në 2016, 16% në 2022). Për më tepër është rritur me 52 pikë përqindje numri i të diplomuarve në 2022 që marrin më shumë se 80,001 lekë (0% në 2016). Kjo është rritja më e madhe ndër vite. Në raport me vitin e kaluar kemi një rritje me 27 pikë përqindje.


Figura 13: Niveli i pagave një vit pas diplomimit (net)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=6); 2017 (N=9); 2018 (N=26) 2019 (N=27); 2020 (N=41), 2021 (N=55); 2022 (N=52)

Sipas të dhënave të disagreguara sipas drejtimeve (shiko figurën 14), vëmë re se 54% e të diplomuarve në degën Hoteleri-Turizëm dhe 33% e të diplomuarve në degën Ekonomi-Biznes paguhen më shumë se 80,001 lekë në muaj. Ndërkohë, 17% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes dhe 9% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm paguhen 50,00-65,000 lekë. Për më tepër, 17% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes dhe 20% në Hoteleri-Turizëm paguhen 35,001 – 50,000 Lekë. Theksojmë, se nuk ka të diplomuar në degën Ekonomi-Biznes që marrin më pak se paga minimale por ka 2% të të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm që marrin më pak se paga minimale. E përkthyer kjo në numër absolut 1 (një) i diplomuar merr më pak sesa paga minimale.

Figura 14: Niveli i pagave sipas drejtimit (2022)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N_{EB}=6, N_{TH}=13, N_{HT}=46

Nga të dhënat e disagreguara sipas gjinisë (figura 15), shohim se edhe pse numri i vajzave të gjurmara në 2022 është i vogël (12 vajza në raport me 40 djem), 42% e tyre marrin një pagë mujore më shumë se 80,001 lekë. E shprehur në numër absolut 5 nga 12 vajzat marrin pagën e mësipërme. Ndërkohë,

55% e djemve marrin një pagë mujore më shumë se 80,001 lekë. E shprehur në numër absolut 22 nga 40 djemtë e gjurmuar marrin më shumë se 80,001 lekë. Për më tepër, 5% (N=2) djem dhe 8% (N=1) vajza marrin një pagë 65,001-80,000 lekë.

Figura 15: Niveli i pagave sipas gjinisë (2022)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** M (N=40); F (N=12).

3.5 Kushtet e punës

Të pyetur lidhur me karakteristikat kryesore të punës (me kohë të plotë apo të pjesshme), për të shtatë brezat e gjurmuar vërehet një punësim mbi mesataren me kohë të plotë. Përqindjen më të ulët e kanë pasur të diplomuarit e vitit 2020 me 66%. Në të njëjtin vit (2020), vërehet një rritje e numrit të atyre që punojnë me kohë të plotë, sezonale (22%) në krahasim me dy vitet e mëparshme. Ndërkohë, për vitin 2022, 90% e të diplomuarve shprehen se punojnë me kohë të plotë, 5% me kohë të plotë sezonale dhe 5% me kohë të pjesshme.


Figura 16: Punësimi me kohë të plotë përkundrejtë me kohë të pjesshme (2016-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=4); 2017 (N=7); 2018 (N=24) 2019 (N=21); 2020 (N=32), 2021 (N=50); 2022 (N=39)

Për sa i përket shpërndarjes së të diplomuarve sipas tipologjisë së kompanisë (shiko figurën 17), në brezin e fundit të të gjurmuarve vërehet se 36% e të diplomuarve punojnë në kompani me 1-4 punonjës, 21% në kompani me 5-9 punonjës, dhe 38% në kompani me 10-49 punonjës. Numri i të diplomuarve që punojnë në kompani me mbi 50 punonjës vazhdon të mbetet i ulët 5%. Kjo kategori ka pësuar një ulje me 20 pikë përqindje nga brezi i parë i gjurmuar (25% në 2016)

Figura 17: Madhësia e kompanisë (2016-2022)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=4); 2017 (N=7); 2018 (N=24) 2019 (N=21); 2020 (N=32), 2021 (N=50); 2022 (N=39)

Në vitin 2022, 65% e të diplomuarve kanë një kontratë pune me punëdhënësin e tyre (shiko figurën 18). Nga ku 44% kanë një kontratë pune me afat të caktuar dhe 21% me afat të pacaktuar. Ndërkohë, i lartë është numri i atyre që nuk kanë një kontratë (36%). E shprehur në numër absolut 14 të diplomuar nuk kanë një kontratë pune me punëdhënësin e tyre. Në këtë kategori kemi një rritje me 34 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë (2% në 2021).

Sikurse vihet re edhe nga figura 17, lloji i kontratës që mbizotëron është ajo me afat të pacaktuar. Mesatarja e të shtatë brezave të gjurmuar është 46%. Ndërkohë, mesatarja e atyre me kontratë me afat të caktuar është 36% për të shtatë brezat e gjurmuar.


Figura 18: Lloji i kontratës (2016-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=4); 2017 (N=7); 2018 (N=24) 2019 (N=21); 2020 (N=32), 2021 (N=50); 2022 (N=39)

Sipas rezultateve të gjurmimit të të shtatë brezave, mesatarisht 76% e të diplomuave të punësuar deklarojnë se iu paguhen kontributet e detyrueshme nga ana e punëdhënësit (shiko figurën 19). Në vitin 2022 kemi një rritje prej 10 pikë përqindje referuar viteve 2020 dhe 2021 (66% secili). Ndërkohë, gjatë vitit 2022 është rritur edhe numri i atyre të cilëve nuk u paguhen sigurimet. Ky vit ka shënuar masën 18%, ndërkohë që mesatarja 2016-2021 ka qenë 8%. Për më tepër, është ulur numri i të diplomuarve të cilët nuk kanë informacion nëse u paguhen apo jo kontributet në 5% (2022), nga 16% (mesatarja 2016-2021).

Figura 19: Ndërgjegjësimi rreth pagesës së sigurimeve nga punëdhënësi (2016-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=4); 2017 (N=7); 2018 (N=24) 2019 (N=21); 2020 (N=32), 2021 (N=50); 2022 (N=39)

3.6 Perceptimet mbi stabilitetin dhe kënaqshmërinë me vendin e punës

Të pyetur se sa të sigurt dhe të stabilizuar ndjeheshin në vendin e tyre të punës, 69% e të diplomuarve në vitin 2022, u shprehën se ndjehen “të sigurt ose shumë të sigurt” (shiko tabelën 5). Ndërkohë, të diplomuarit që janë shprehur “shumë të pasigurt” janë vetëm 10%. Vërehet se nga të diplomuarit e gjurmuar në vitin 2020, vetëm 3% ndiheshin “shumë të sigurt” dhe nga të diplomuarit e viti 2022 vetëm

8%, ndërkohë që në vitin 2022, 23% ndiheshin “shumë të sigurt”. Në vitin 2022, kategoria “të sigurt ose shumë të sigurt”, arriti nivelin më të lartë ndër vite.

Ndërkohë, të pyetur lidhur me kënaqësinë në vendin e punës, 66% e të diplomuarve në vitin 2022 shprehen se ndjehen “të kënaqur ose shumë të kënaqur” dhe vetëm 5% shprehen “shumë të pakënaqur”. Sikurse e tregon edhe tabela 5, numri i atyre që shprehen shumë të pakënaqur ka rënë me 37 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë. E shprehur në numër absolut vetëm 2 (dy) të diplomuar në 2022 u shprehën shumë të pakënaqur në krahasim me 21 (njëzetëenjë) në vitin 2021.

Tabela 5: Përceptimi për sigurinë dhe kënaqësinë në punën aktuale (2016-2022)


	Të diplomuar në 2016	Të diplomuar në 2017	Të diplomuar në 2018	Të diplomuar në 2019	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
Shumë i/e pasigurt	1 (25%)	1 (14%)	0%	1 (5%)	7 (22%)	16 (32%)	4 (10%)
I/e pasigurt	0%	1 (14%)	3 (13%)	1 (5%)	8 (16%)	5 (16%)	2 (13%)
Neutral	0%	2 (29%)	11 (46%)	9 (43%)	10 (31%)	12 (24%)	3 (8%)
I/e sigurt	1 (25%)	3 (43%)	9 (38%)	7(33%)	9 (28%)	10 (20%)	18 (46%)
Shumë i/e sigurt	2 (50%)	0%	1 (4%)	3 (14%)	1 (3%)	4 (8%)	9 (23%)
Shumë i/e pakënaqur	0%	0%	0%	1 (5%)	7 (22%)	21 (42%)	2 (5%)
I/e pakënaqur	0%	1 (14%)	2 (8%)	2 (10%)	2 (6%)	6 (12%)	6 (15%)
Neutral	0%	3 (43%)	12 (50%)	2 (10%)	12 (38%)	9 (18%)	5 (13%)
I/e kënaqur	2 (50%)	2 (29%)	8 (33%)	10 (48%)	9 (28%)	13 (26%)	15 (38%)
Shumë i/e kënaqur	2 (50%)	1 (14%)	2 (8%)	6 (29%)	2 (6%)	1 (2%)	11 (28%)

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=4); 2017 (N=7); 2018 (N=24) 2019 (N=21); 2020 (N=32), 2021 (N=50); 2022 (N=39)

3.7 Kohëzgjatja e gjetjes së punës së parë

Të pyetur për kohën që u duhet të presin derisa të fillojnë punën e tyre të parë, 84% e të diplomuarve në vitin 2022 u përgjigjën se kanë arritur të gjejnë punën para diplomimit. Në vitin 2021 (shiko tabelën 6) vetëm 49% e të diplomuaritve u përgjigjën se kishin arritur të gjenin punë para se të përfundojnë shkollën. 2022-shi shënon vitin me numrin më të lartë të atyre që e fillojnë punën para se të diplomohen. Rritja është 31 pikë përqindje referuar mesatares vjetore të viteve 2016-2021 (53%).

Figura 20: Periudha kohore në kërkim të një pune (të diplomuarit 2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N=43

Ndërkohë, 5% e të diplomuarve arrijnë të gjejnë punë 1 muaj pas diplomimit, mesatarja e viteve 2016-2021 është 15%. Pra, për këtë kategori vërehen përmirësime me 10 pikë përqindje. Përmirësime vërehen edhe në numrin e atyre të diplomuarve që gjejnë punë 1-3 muaj pas diplomimit (5% në 2022,

përkundrejt 11% (mesatarja) në vitet 2016-2021), si dhe atyre që e gjejnë punën 3-6 muaj pas diplomimit (2% në 2022, përkundrejt 5% (mesatarja) në vitet 2016-2021). Vlen të theksohet se përqindja e atyre që gjejnë punë 1 vit pas diplomimit vijon të mbetet 0 (zero) për të gjithin vit radhazi.

Tabela 6: Periudha kohore në kërkim të një pune (2016-2022)

	Të diplomuar në 2016	Të diplomuar në 2017	Të diplomuar në 2018	Të diplomuar në 2019	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
Para diplomimit	40%	45%	53%	77%	53%	49%	84%
1 muaj pas diplomimit	40%	0%	23%	4%	11%	14%	5%
1 - 3 muaj pas diplomimit	0%	36%	7%	4%	8%	8%	5%
3 - 6 muaj pas diplomimit	0%	9%	7%	4%	3%	8%	2%
6 - 9 muaj pas diplomimit	0%	9%	0%	4%	11%	10%	2%
9 - 12 muaj pas diplomimit	0%	0%	10%	8%	14%	12%	2%
Më shumë se 1 vit pas diplomimit	20%	0%	0%	0%	0%	0%	0%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=5); 2017 (N=11); 2018 (N=30); 2019 (N=26); 2020 (N=36); 2021 (N=51); 2022 (N=43)

3.8 Mënyrat e gjetjes së punës së parë

Të pyetur për mënyrën e gjetjes së punës së parë, vërehet se të diplomuarit e vitit 2022 shprehen në masën 42% se e kanë gjetur punën nga praktika profesionale në biznes. Kjo mënyrë shënon një rritje me 20 pikë përqindje në raport me mesataren e viteve 2016-2021 (22%).

Ndërkohë, mënyra që mbizotëron në të shtatë brezat e gjurmuar për gjetjen e një pune janë lidhjet personale të pjesëtarëve të familjes dhe të njohurit e tyre me një mesatare prej 33% (2016-2022). Pas saj renditet praktika profesionale me një mesatare prej 22% (2016-2022).

I konsiderueshëm është edhe numri i atyre që gjejnë një punë përmes njoftimeve në faqe interneti, media sociale apo gazeta, me një mesatare prej 15% (2016-2022).

Tabela 7: Mënyrat e gjetjes së punës së parë (2016-2022)

	Të diplomuar në 2016	Të diplomuar në 2017	Të diplomuar në 2018	Të diplomuar në 2019	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
Nga njoftimet për punë në faqe interneti, media sociale, gazetë	20%	9%	7%	4%	19%	29%	16%
Nga njohjet, lidhjet familjare, miqtë	80%	18%	33%	23%	28%	25%	26%
Nga praktika profesionale në biznes	0%	18%	33%	35%	28%	20%	42%
Duke kontaktuar drejtpërdrejtë me punëdhënësin tim	0%	27%	23%	12%	11%	6%	5%
Nga mësuesit	0%	9%	3%	12%	6%	10%	9%
Nga Zyra e Punësimit	0%	9%	0%	0%	3%	2%	0%
Nga qendra e karrierës/njësia e zhvillimit në shkollë	0%	9%	0%	12%	3%	8%	2%
Tjetër	0%	0%	0%	4%	3%	0%	0%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=5); 2017 (N=11); 2018 (N=30); 2019 (N=26); 2020 (N=36); 2021 (N=51); 2022 (N=43)

Lidhur me mënyrat e mbështetjes së shkollës në kapërcimin e fazës tranzitore drejt tregut të punës (shiko tabelën 8), në vitin 2022, 40% pohuan se shkolla i ka ndihmuar në orientimin mbi mundësitë e ndryshme për punësim (nuk ka ndryshim referuar vitit 2021), 31% i ka ndihmuar për të vendosur kontakte me punëdhënës potencialë (rritje me 2 pikë përqindje referuar vitit 2021) dhe 29% pohuan se shkolla i ka mësuar se si të aplikojnë për punë (ulje me 6 pikë përqindje referuar vitit 2021).

Ndërkohë 3 (tre) të diplomuar të gjurmuar ose 6% janë shprehur se shkolla nuk i ka ndihmuar për gjetjen e një pune (rritje me 2 pikë përqindje referuar vitit 2021).

Tabela 8: Ndihma e shkollës në gjetjen e punës së pare (2016-2022)


	Të diplomuar në 2016	Të diplomuar në 2017	Të diplomuar në 2018	Të diplomuar në 2019	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
Kam mësuar si të kërkoj dhe të aplikoj për punë	0%	31%	38%	22%	39%	35%	29%
Më ka orientuar mbi mundësitë e ndryshme të punësimit	83%	23%	62%	41%	22%	40%	40%
Më ka ndihmuar për të vendosur kontakte me punëdhënës potencialë	0%	8%	46%	31%	17%	29%	31%
Përgjithësisht nuk më ka ndihmuar	17%	38%	8%	9%	15%	4%	6%
Tjetër	17%	0%	0%	3%	10%	4%	2%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=6); 2017 (N=13); 2018 (N=26); 2019 (N=32); 2020 (N=41); 2021 (N=55); 2022 (N=52)

3.9 Të diplomuarit që ndjekin kualifikime të mëtejshme

Përqindja e të diplomuarve të cilët vazhdojnë kualifikime të mëtejshme ka ardhur në zbritje (shiko figurën 21). Numri i të diplomuarve që punojnë dhe studiojnë në të njëjtën kohë, është ulur në 8%. Në vitin 2020 kemi pasur përqindjen më të lartë të tyre 17%. Kjo përqindje u ul në 11% në vitin 2021 dhe më tej në 8% në vitin 2022. Në vitin 2022, niveli i të diplomuarve që vetëm studiojnë është 7% dhe kemi një rritje në raport me vitin 2021 ku asnjë i diplomuar nuk ishte student apo kursant. Megjithatë, kjo kategori ka pësuar ulje nga mesatarja e viteve 2016-2021 me 4 pikë përqindje.


Figura 21: Ndjekja e kualifikimeve të mëtejshme (2016-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=8); 2017 (N=19); 2018 (N=45); 2019 (N=43); 2020 (N=63); 2021 (N=62); 2022 (N=61)

Sikurse në vitet paraardhëse, pjesa më e madhe e të diplomuarve në 2022 që ndjekin kualifikime të mëtejshme kanë zgjedhur universitetin 56%, (5 nga 9 të gjurmuar), 22% (2 nga 9 të gjurmuar) studiojnë pranë një shkolle profesionale pas të mesmes dhe 22% (2 nga 9 të gjurmuar) ndjekin një kurs profesional. Vihet re se vit pas vit numri i atyre që vijojnë studimet e larta ka rënë. Në vitet 2016-2021 mesatarja e atyre që vijonin studimet e larta ishte 79% ndërkohë ne vitin 2022 ka rënë në 56%.


Figura 22: Llojet e kualifikimeve të mëtejshme (2016-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shumta e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=1); 2017 (N=3); 2018 (N=7); 2019 (N=5); 2020 (N=18); 2021 (N=7); 2022 (N=9)

Nga të diplomuarit që ndjekin studime të mëtejshme universitare, për vitin 2022, 100% ndjekin një institucion publik.

Figura 23: Lloji i institucionit (2020-2022)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shumta e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2020 (N=18); 2021 (N=7); 2022 (N=9)

Ndërkohë, të pyetur nëse studimet/trajnimet që po ndjekin lidhen me shkollën që kanë bërë (shiko figurën 23), 89% (8 nga 9) e të gjurmuarve që studiojnë janë shprehur se fusha e studimeve që po ndjekin tani lidhet me shkollën që kanë bërë, përkundrejt 11% (1 nga 9) të cilët shprehen se studimet e mëtejshme nuk lidhen me shkollën që kanë bërë. Nga viti 2020 deri në 2022 mesatarisht 80% e të

gjurmuarve shprehen se studimet/trajnimet që ndjekin lidhen me shkollën që kanë bërë, përkundrajt 20% të cilët pohojnë se nuk lidhen.

Figura 24: Lidhja e studimeve me profesionin (2020-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2020 (N=18); 2021 (N=7); 2022 (N=9)

Të pyetur mbi arsyet e ndjekjes së studimeve të mëtejshme (shiko tabelën 9), 22% e të diplomuarve në 2022 janë përgjigjur për të fituar një kualifikim më të lartë (66% mesatarja e vitetve 2016-2021), 33% për të rritur mundësitë për të gjetur një punë më të mirë (22% mesatarja e vitetve 2016-2021), dhe 44% për të ndjekur një karrierë tjetër profesionale (13% mesatarja e vitetve 2016-2021). Kategoria e fundit ka pësuar një rritje me 31 pikë përqindje krahasuar me mesataren e viteve të mëparshme.

Tabela 9: Arsyet kryesore për ndjekjen e kualifikimeve të mëtejshme (2016-2022)


	Të diplomuar në 2016	Të diplomuar në 2017	Të diplomuar në 2018	Të diplomuar në 2019	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
Për të fituar një kualifikim më të lartë	100%	33%	71%	75%	28%	86%	22%
Për të rritur mundësitë për të gjetur një punë më të mirë	0%	67%	29%	0%	33%	0%	33%
Për të ndjekur një karrierë tjetër profesionale	0%	0%	0%	25%	39%	14%	44%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=1); 2017 (N=3); 2018 (N=7); 2019 (N=4); 2020 (N=18); 2021 (N=7); 2022 (N=9)

3.10 Të diplomuarit pa punë

Niveli i të diplomuarve të papunë një vit pas diplomimit për vitin 2022 ka rënë në 7%. Kjo është norma më e ulët e papunësisë për të shtatë brezat e gjurmuar. Mesatarja nga viti 2016-2020 ka qenë 22%.


Figura 25: Papunësia ndër vite



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=8); 2017 (N=19); 2018 (N=45); 2019 (N=43); 2020 (N=63); 2021 (N=62); 2022 (N=61)

Të pyetur nëse po kërkonin punë, 2 nga 4 të diplomuarit e papunë të vitit 2022 u përgjigjën që po. Një vit më parë 1 nga 7 të diplomuarit e papunë u shpreh se ishte në kërkim të një pune. Të njëjtat vlera kanë qenë edhe gjatë viti 2020 ku vetëm 2 nga 12 të diplomuarit e papunë u shprehen se po kërkonin një punë.

Figura 26: Niveli i të diplomuarve pa punë që kërkojnë për punë (2020-2021)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2020 (N=14); 2021 (N=7); 2022 (N=4)

100% e të diplomuarve të papunë për vitin 2022 janë shprehur se nuk kanë njohjet/kontaktet e duhura për të gjetur një punë. Një vlerësim krahasues me vitet e kaluara (shiko tabelën 10), nxjerr në pah se arsytet më madhore që mendohet se sjellin pamundësinë për të gjetur një punë janë: oferta për punë nuk lidhet me arsimimin tim (34% mesatarja 2016-2021, 0% 2022) si dhe nuk kam njohjet/kontaktet e duhura për të gjetur një punë (13% mesatarja 2016-2021, 0% 2022).


Tabela 10: Arsyet kryesore pas papunësisë (2016-2022)

	Të diplomuar në 2016	Të diplomuar në 2017	Të diplomuar në 2018	Të diplomuar në 2019	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
Më mungon eksperiencia e punës	0%	17%	42%	0%	0%	0%	0%
Njohuritë që kam marrë nga shkolla nuk përputhen me tregun e punës	100%	0%	8%	9%	0%	0%	0%
Ofertat për punë nuk lidhen me arsimimin tim	0%	17%	8%	27%	50%	100%	0%
Nuk kam njohjet/kontaktet e duhura për të gjetur një punë	0%	0%	17%	9%	50%	0%	100%
Nuk ka punë në qarkun tim	0%	50%	8%	9%	0%	0%	0%
Jam i/e angazhuar në punë familjare	0%	0%	17%	0%	0%	0%	0%
Nga situata e krijuar nga pandemia e COVID-	0%	17%	0%	18%	0%	0%	0%
Nuk kam burime të mjaftueshme për t'u vetë-punësuar	0%	17%	42%	0%	0%	0%	0%
Tjetër	100%	0%	8%	9%	0%	0%	0%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=1); 2017 (N=6); 2018 (N=12); 2019 (N=11); 2020 (N=2); 2021 (N=1); 2022 (N=2)

Të pyetur rreth formave që përdorin për të kërkuar një vend pune (shiko figurën 27), 100% (2 nga 2) e të diplomuarve në 2022 janë përgjigjur nëpërmejt zyrës së punës, 100% duke kontaktuar drejtëpërdrejtë me biznesin, si dhe 100% nëpërmjet shkollës. Vëreni se të gjurmuarit mund të zgjedhin më shumë se një alternativë për këtë pyetje. Ndërkohë, kërkimi i një vendi pune përmes njohjeve, lidhjeve familjare, miqve dhe të njohurve shihet si një faktor (50%) por jo më i rëndësishëm sesa të mësipërmit.

Figura 27: Metodatat e kërkimit për punë (2020-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2020 (N=2); 2021 (N=1); 2022 (N=2)

Të pyetur për arsyet e mos kërkimit të një pune (shiko tabelën 11), 2 nga të diplomuarit e gjurmuar (100%) u përgjigjën që po presin të fillojnë punë së shpejti. Këtë vit, ndryshe nga dy vitet e mëparshme

askush nga të diplomuarit e papunë të gjurmuar nuk është shprehur se ka në plan të largohet nga vendi. Në vitin 2021, 1 nga 6 të gjurmuarit pohoi se do largohej nga vendi.


Tabela 11: Arsyet kryesore e mos kërkimit për punë (2020-2022)

	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
Po pres të filloj punë së shpejti	0	0	2
Nuk kam besim se do gjej një punë	3	1	0
Nuk kam dëshirë të punoj për momentin	3	2	0
Kam në plan të largohem nga vendi	2	1	0
Tjetër	3	0	0

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2020 (N=12); 2021 (N=6); 2022 (N=2)

Sikurse e tregon edhe figura 28, numri i të diplomuarve të papunë që kanë qenë në marrëdhënie pune më parë është ulur nga viti 2016 deri në vitin 2021, ndërkohë në vitin 2022 ka pësuar një rritje me 86 pikë përqindje.

Figura 28: Niveli i të diplomuarve papunë që kanë qenë në marrëdhënie pune (2016-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=1); 2017 (N=6); 2018 (N=12); 2019 (N=11); 2020 (N=14); 2021 (N=7); 2022 (N=4)

3.11 Propozimet për përmirësim në shkollë

Të pyetur se për çfarë aspektesh ka nevojë për përmirësim shkolla me qëllim përgatitjen më të mirë të nxënësve për tregun e punës, të gjurmuarit pohuan se të gjitha aspektet e shkollës të paraqitura në tabelën 12 kanë “shumë/jashtëzakonisht shumë” nevojë për përmirësim. Sipas rezultateve të të diplomuarve në vitin 2022, mbi 26% e të gjurmuarve vlerësojnë se çdo aspekt i shkollës ka nevojë për përmirësim “shumë/jashtëzakonisht shumë”. Theksi këtë vit është tek nevoja për përmirësim të praktikës në biznes, 41% (me një rritje me 21 pikë përqindje krahasuar me vitin 2021). Për më tepër,

kërkohet të përmirësohet bashkëpunimi me bizneset (39%), praktika në shkollë (36%), këshillimi i karrierës (36%) si dhe metodat e mësimdhënies (31%).


Tabela 12: Përqindja e aspekteve ku ka nevojë për përmirësim në shkollë “shumë/jashtëzakonisht shumë” (2016-2022)

	Të diplomuar në 2016	Të diplomuar në 2017	Të diplomuar në 2018	Të diplomuar në 2019	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
Infrastruktura	17%	62%	4%	38%	52%	18%	26%
Kurrikula	0%	0%	8%	53%	46%	22%	26%
Tekstet dhe materialet	67%	46%	12%	47%	41%	17%	30%
Metodat e mësimdhënies	33%	39%	8%	47%	30%	20%	31%
Aftësitë teorike dhe praktike të mësuesve	0%	0%	15%	50%	30%	22%	30%
Praktika në shkollë	33%	31%	12%	63%	44%	14%	36%
Praktika në biznes	33%	23%	12%	59%	44%	20%	41%
Këshillimi i karrierës	33%	0%	12%	50%	44%	20%	36%
Bashkëpunimi me bizneset	33%		12%	53%	41%	15%	39%
Bashkëpunimi me zyrat e punësimit	0%	8%	8%	56%	33%	12%	28%

Shënim: Kjo është pyetje ku janë marrë të dhënat e të diplomuarve që janë përgjigjur “shumë/jashtëzakonisht shumë”. Shuma e përqindjeve nuk është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=6); 2017 (N=13); 2018 (N=26); 2019 (N=32); 2020 (N=63); 2021 (N=60); 2022 (N=61)

Nëse do të kishin mundësi, 85% e të diplomuarve do të zgjidhnin të njëjtin drejtim profesional dhe 89% të njëjtën shkollë (shiko figurën 28). Mesatarisht, nga viti 2018-2022, 76% e të diplomuarve do të përzgjidhnin të njëjtën degë, dhe 79% të njëjtën shkollë.

Figura 29 Përzgjedhja e së njëjtës shkollë dhe degë (2018-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shumta e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2018 (N=45); 2019 (N=43); 2020 (N=63); 2021 (N=62); 2022 (N=61)

Të disagreguara sipas drejtimeve, përzgjedhja e të njëjtës degë dhe shkollë paraqitet në tabelën 13. Vëmë re se të diplomuarit e degës Ekonomi-Biznes do e përzgjidhnin të njëjtën degë në masën 60% (mesatarja e viteve 2018-2021), ndërkohë në vitin 2022 në masën 89%. Pra, vërehet një rritje me 29 pikë përqindje nga mesatarja e viteve. Ndërkohë, këta të diplomuar do përzgjidhnin të njëjtën shkollë në masën 64% (mesatarja e viteve 2018-2021), ndërsa të diplomuarit e vitit 2022 në masën 89%. Pra, vërehet një rritje me 25 pikë përqindje nga mesatarja e viteve.

Ndërkohë të diplomuarit në degën Hoteleri-Turizëm do të përzgjidhnin të njëjtën degë në masën 80% (mesatarja e viteve 2018-2021), dhe 85% për vitin 2022, dhe të njëjtën shkollë në masë 83% (mesatarja e viteve 2018-2021), dhe 88% të diplomuarit e vitit 2022. Pra kemi një rritje me 5 pikë përqindje për përzgjedhjen e së njëjtës degë dhe së njëjtës shkollë nga të diplomuarit e degës Hoteleri-Turizëm.


Tabela 13: Përzgjedhja e së njëjtës degë dhe shkollë sipas drejtimit (2018-2022)

		Ekonomi-Biznes	Hoteleri-Turizëm
Të diplomuar në 2018	Degë	25%	91%
	Shkollë	75%	94%
Të diplomuar në 2019	Degë	94%	85%
	Shkollë	100%	85%
Të diplomuar në 2020	Degë	37%	72%
	Shkollë	41%	69%
Të diplomuar në 2021	Degë	84%	72%
	Shkollë	42%	84%
Të diplomuar në 2022	Degë	89%	85%
	Shkollë	89%	88%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shumta e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza 2018:** N_{EB}=12, N_{HT}=33; **Baza 2019:** N_{EB}=16, N_{HT}=27; **Baza 2020:** N_{EB}=27, N_{HT}=36; **Baza 2021:** N_{EB}=19, N_{HT}=43; **Baza 2022:** N_{EB}=9, N_{HT}=52

Të ndara sipas gjinisë përzgjedhja e të njëjtës degë studimi jepet në figurën 30. Sikurse vihet re, ndonëse numri vajzave është i vogël ato do të përzgjidhnin të njëjtën degë në masën 93%. Ndërkohë, djemtë do e përzgjidhnin të njëjtën degë në masën 83%. Për të dy gjinitë, shkalla më e ulët e përzgjedhjes së të njëjtës degë është shënuar në vitin 2020, ku 43% e vajzave dhe 61% e djemve do përzgjidhnin të njëjtën degë. Pas këtij viti kemi një rritje graduale për të dy gjinitë. Përkatësisht, vërehet një rritje me 50 pikë përqindje për vajzat (nga 2020 në 2022) dhe me 22 pikë përqindje për djemtë, në të njëjtën periudhë.

Figura 30: Përzgjedhja e së njëjtës degë studimi (2018-2022)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shumta e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza M:** 2018 (N=36); 2019 (N=35); 2020 (N=49); 2021 (N=49); 2022 (N=47); **Baza F:** 2018 (N=9); 2019 (N=8); 2020 (N=514); 2021 (N=13); 2022 (N=14)

Edhe për përzgjedhjen e së njëjtës shkollë, vërehet se vajzat do e përzgjidhnin të njëjtën shkollë në masën 33% (2022) dhe djemtë në masën 87%. Sërish, edhe këtu vlera më e ulët e përzgjedhjes së të

njëjtës shkollë është viti 2020 me përkatësisht 43% të vajzave dhe 61% të djemve. Më pas kemi një rritje me 50 pikë përqindje (nga 2020 në 2022) për vajzat dhe me 26 pikë përqindje për djemtë, në të njëjtën periudhë.

Figura 31: Përzgjedhja e së njëjtës shkollë (2018-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shumta e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza M:** 2018 (N=36); 2019 (N=35); 2020 (N=49); 2021 (N=49); 2022 (N=47); **Baza F:** 2018 (N=9); 2019 (N=8); 2020 (N=514); 2021 (N=13); 2022 (N=14)

3.12 Planet për të ardhmen

Të pyetur për planet që kanë të diplomuarit për të ardhmen e tyre të afërt në aspektin profesional dhe të kualifikimit të mëtejshëm (shiko tabelën 14), 41% e të diplomuarve në vitin 2022 kanë pohuar se kanë dëshirë të kenë filluar biznesin e tyre. Aspiratat për sipërmarrje në këtë vit kanë shënuar rritje në raport me mesataren e viteve 2016-2021 e cila ka qenë 29%. Ndërkohë, aspiratat kanë pësuar një rënie me 11 pikë përqindje në raport me një vit më parë.

Parë në një këndvështrim krahasues, në planet e tyre për të ardhmen, mesatarisht 25% e të diplomuarve shprehen se dëshirojnë të jenë të punësuar dhe 23% të gjejnë një punë të lidhur ngushtë me fushën e tyre të studimit. Ndërkohë, 29% (mesatarja e 7 brezave) shprehen se do ndjekin studime të mëtejshme dhe 36% se duan të emigrojnë jashtë vendit. Në këtë zë kemi një ulje me 51 pikë përqindje në vitin 2022 (15%), në raport me vitin 2021 (66%). Ndërkohë, dëshira për migrim të brendshëm është 2% për vitin 2022, me një ulje me 5 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2016-2021.

Tabela 14: Planet e të diplomuarve për dy vitet e ardhshme (2016-2022)

	Të diplomuar në 2016	Të diplomuar në 2017	Të diplomuar në 2018	Të diplomuar në 2019	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
Të jem punësuar	0%	5%	20%	16%	10%	16%	25%
Të kem gjetur një punë që të lidhet me fushën time të studimit	13%	0%	33%	30%	27%	29%	23%
Të kem filluar biznesin tim	13%	5%	51%	28%	27%	52%	41%
Të kem ndjekur studime të mëtejshme	13%	42%	44%	30%	14%	45%	15%
Të kem emigruar jashtë vendit	13%	37%	51%	28%	44%	66%	15%

Të kem migruar në një qytet tjetër brenda vendit	13%	5%	7%	5%	3%	10%	2%
Tjetër	75%	5%	0%	2%	3%	0%	2%

Shënim: Kjo është pyetje me përgjigje të shumëfishta. Shuma e përqindjeve nuk është e barabartë me 100%. **Baza:** 2016 (N=2); 2017 (N=19); 2018 (N=45); 2019 (N=43); 2020 (N=63); 2021 (N=62); 2022 (N=61)

4. Përfundime

Në këtë raport paraqiten rezultatet kryesore nga gjurmimi i të diplomuarve të Shkollës Tregtare duke filluar me brezin e nxënësve të diplomuar në vitin 2016.

Disa nga gjetjet kryesore të gjurmimit për të diplomuarit e 2022 janë përmbledhur më poshtë:

- 100% e të diplomuarve të 2022 u gjurmuan një vit pas diplomimit.
- Nga një total prej 61 të anketuarish, 77% e tyre ishin në marrëdhënie pune (punësim/vetëpunësim), 7% pa punë, 7% po ndiqnin kualifikime të mëtejshme dhe 8% ishin të punësuar por edhe studionin në të njëjtën kohë. Dy vitet e fundit shënojnë vlerat më të larta të punësimit në të shtatë brezat dhe ato më të ulëta të papunësisë.
- 67% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes dhe 88% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm janë të punësuar. Vetëm 8% e të diplomuarve në degën Hoteleri-Turizëm janë të papunë, ndërkohë asnjë i diplomuar në degën Ekonomi-Biznes nuk është i papunë.
- 88% e të diplomuarve në 2022 pohojnë se puna që ata bëjnë lidhet me studimet e tyre. Përqindja e të diplomuarve që janë shprehur se i përdorin njohuritë në vendin e punës “shumë/jashtëzakonisht shumë” për vitin 2022 është 46%. Vërehet një rritje me 22 pikë përqindje në krahasim me vitin 2021.
- Shpërndarja e të diplomuarve sipas nivelit të pagave është: 2% më pak se paga minimale, 12% paga minimale-35,000 lekë, 19% në fashën 35,001-50,000 lekë, 10% në fashën 50,001-65,000 lekë, 6% në fashën 65,001-80,000 lekë dhe 52% paguhen më shumë se 80,001 lekë. Pra, më shumë se gjysma e të diplomuarve të vitit 2022 paguhen me një pagë më shumë sesa 80,001 lekë. Një vlerësim krahasues me vitet e kaluara pasqyron një përmirësim të nivelit të pagave të të diplomuarve, sidomos në tre brezat e fundit.
- Sipas të dhënave të disagreguara sipas drejtimeve vëmë re se 54% e të diplomuarve në degën Hoteleri-Turizëm dhe 33% e të diplomuarve në degën Ekonomi-Biznes paguhen më shumë se 80,001 lekë në muaj. Ndërkohë, 17% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes dhe 9% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm paguhen 50,00-60,500 lekë. Nuk ka të diplomuar në degën Ekonomi-Biznes që marrin më pak se paga minimale, por 1 (një) i diplomuar në degën Hoteleri-Turizëm marr më pak se paga minimale.
- 84% e të diplomuarve janë punësuar para se të diplomohen, kjo shënon një rritje në raport me vitin 2021 ku vetëm 49% e të diplomuarve gjenin një punë para se të diplomoheshin. Ndërkohë, 5% janë punësuar një muaj pas diplomimit, 5% deri në tre muaj pas diplomimit dhe vetëm 2 % një vit pas diplomimit.
- Të diplomuarit përgjithësisht ndihen të sigurt dhe të kënaqur në punën e tyre aktuale, ku rreth 69% e tyre janë shprehur “të sigurt/shumë të sigurt” dhe 66% “të kënaqur ose shumë të kënaqur. Vërehet një korrelacion pozitiv mes sigurisë dhe kënaqësisë në vendin e punës.
- Niveli i të diplomuarve të papunë një vit pas diplomimit është 7%. Në vlera absolute kjo shifër shkon në 4 (katër) të diplomuar të papunë. Të pyetur nëse po kërkojnë për një mundësi punësimi, 2 prej tyre (50%) janë përgjigjur po.
- Sipas rezultateve të të diplomuarve në vitin 2022, mbi 26% e të gjurmuarve vlerësojnë se çdo aspekt i shkollës ka nevojë për përmirësim “shumë/jashtëzakonisht shumë”. Përkatesisht, praktika në biznes (41%), bashkëpunimi me bizneset (39%), këshillimi i

karrierës (36%) si dhe metodat e mësimdhënies (31%) vlerësohen se kanë më shumë nevojë për përmirësim. Aspiratat për sipërmarrje në këtë vit kanë shënuar rritje në raport me mesataren e viteve 2016-2021 e cila ka qenë 29%. Ndërkohë, 15% e të diplomuarve dëshirojnë të emigrojnë jashtë vendit. Dëshira për të emigruar ka pësuar një rënie me 51 pikë përqindje në raport me një vit më parë (66% në 2021).